

eppc kërkon një *Head of Finance* për klientin e saj, i cili është një ndër kompanitë më të mëdha në vend.

Qëllimi kryesor i punës:

Kandidati ideal është përgjegjës/e për menaxhimin e të gjithë aspekteve financiare dhe fiskale të operacioneve të kompanisë. Ai/Ajo siguron udhëheqje dhe koordinim në planifikimin administrativ të biznesit, kontabilitetit dhe buxhetit të kompanisë.

Përgjegjësitë Kryesore:

1. Mbikëqyr projektet e investimeve, kontabilitetin, kontrollin dhe raportimin e tyre në kohë dhe me saktësi;
2. Kontrollon dhe supervizon stafin e financës, si dhe siguron një performancë të mirë të funksionimit të përgjithshëm të tij në punë;
3. Koordinon përgatitjen e pasqyrave, raporteve, analizave financiare dhe raporteve të vecanta informative;
4. Krijon, koordinon dhe vlerëson programet financiare dhe sistemet mbështetëse të informacionit të kompanisë për të përfshirë buxhetimin, planifikimin e taksave, investimet dhe ruajtjen e aseteve;
5. Mban dhe menaxhon proceset e kontrollit të brendshëm të kompanisë;
6. Shërben si një drejtues certifikues për të gjitha llogaritë e kompanisë;
7. Zhvillon dhe zbaton procedurat e financave, kontabilitetit, faturimit dhe auditimit;
8. Mbikëqyr menaxhimin financiar të operacioneve të huaja.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare, Dega Financë - Kontabilitet; (*ACCA e preferueshme*)
- Minimalisht përvojë pune 5 vjet në Financë-Kontabilitet në pozicion drejtues;
- Të zotërojë në mënyrë të shkëlqyer gjuhën Shqipe dhe Angleze (*në të folur dhe të shkruar*);
- Eksperiencë e mëparshme në menaxhim dhe kontabilitet projektsh;
- Aftësi të forta teknike në kontroll financiar, kontabilitet, raportim dhe menaxhim performance;
- Aftësi të mira për të drejtuar dhe motivuar njerëzit.

Të dhënat:

Pozicioni:	Head of Finance;
Vendndodhja:	Tiranë;
Orari:	44 orë në javë;
Raporton:	Administratori;
Udhëtime pune	Po, të rralla;
Pagesa:	Në nivel drejtuesi;
Aplikimet mbyllen:	20 Tetor 2014.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail^{it}:

recruitments@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.